



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:280869  
Datë: 25.03.2024  
Numri i dokumentit: 05499644

**PPP.nr.235/22**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESco), me seli në Prishtinë, Bulevardi Bill Clinton, Nr.5, kundër debitorit L.E.P. R.Q.V., me seli në Shtime, rr “...”, nr.... të cilën me autorizim e përfaqëson av Liridon Jetishi nga Ferizaj, për pagesën e borxhit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga i autorizuari i debitorit, me datë 25.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**HIDHET si jo komplet** prapësimi i të autorizuarit të debitorit LIDHJE E PËRKOHSHME R.Q.V., i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.370/2022, të datës 22.06.2022, i lëshuar nga përmbartuesi privat B.A. nga Ferizaj dhe **MBETET** në fuqi urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.370/2022, i datës 22.06.2022.

**A r s y e t i m**

Me urdhrin P.nr.370/2022, të datës 22.06.2022, përmbartuesi privat B.A. e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a, kundër debitorit L.E.P. R.Q.V., për pagesën e borxhit në shumë prej 861.53 euro dhe shpenzimet e procedurës, në bazë të ekstraktit të librave afariste DFE – ..., të datës 21.06.2022, si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës së përmbartimit, ose ndalimin në mjetet në para

përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit ose regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit, i autorizuari i debitorit, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi si i bazuar dhe të anulohet urdhri për përmbarim.

Kreditori ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit, me të cilën i ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të prapësimit të debitorit, gjeti se i njëjti është i pa nënshkruar dhe si i tillë është jo komplet dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 69, par 6, të LPP-së.

Për më tepër në nenin 69, par 6, të LPP-së, është paraparë shprehimisht se: *“Prapësimi do të përmbaj të dhënat e vendimit përmbarimor kundër të cilit është bërë ankesa, arsyet e prapësimit dhe nënshkrimin e debitorit”*.

Andaj, Gjykata duke i marr parasysh faktet e cekura më lart, konstatoj se nuk ka mundur të lëshohet në vlerësimin e pretendimeve të autorizuarit të debitorit në prapësim, për shkak të mungesës së nënshkrimit të autorizuarit të debitorit në prapësimin e ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit dhe prapësimin e debitorit e hedhi si jo komplet ndërsa urdhri mbi lejimin e përmbarimit P.nr.370/2022, i datës 22.06.2022, të mbetet në fuqi.

Nga të cekurat më lart dhe në bazë të nenit 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**PPP.nr.235/22, më datë 25.03.2024**

**GJYQTARI**

**Faton Ajvazi**

### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.